



Pranuar / Dorezuar Punijeno/Prodato Received/Delivery	08 - 04 2022	2	viti god year
Organ /Hjesia Organ /Jodnica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojta Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SHMISHCK	2007/2022		1/5



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.159/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë, si dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.159/2022 të datës 23.02.2022 të parashtruar nga ankuesi

me adresë

Prishtinë, kundër organit të punësimit Agjencia për Pronësi Industriale/Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë /, në çështjen juridike "Vlerësimi i punës për vitin 2021", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 08.04.2022 mori këtë:

V E N D I M

I. **ANULOHET** Vlerësimi i rezultateve në punë për vitin 2021 i datës 03.02.2022 për ankuesin

II. **OBLIGOHET** Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë për Pronësi Industriale /Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmerre veprimet e nevojshme me qëllim që të bëhet vlerësimi për vitin 2021 nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankuesit që ka qenë në vitin 2021.

III. **OBLIGOHET** Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë për Pronësi Industriale/Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, që ti ndërmarrë të gjitha veprimet për zbatimin e këtij vendimi.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në pozitën “Zyrtar për të hyra financiare” sipas Akt emërimit të datës 21.06.2019 në Agjencinë për Pronësi Industriale/Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregëtisë. Me datë 03.02.2022 është vlerësuar për pesë(5) muajt e fundit të vitit 2021 duke e vlerësuar ankuesin me notën e përgjithshme 2.2 ndërsa për periudhën Janar - Korrik ankuesi nuk është vlerësuar.

I pakënaqur me vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021, ankuesi me datë 23.02.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 952/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me datë 03.03.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit tek Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregëtisë /Agjencia për Pronësi Industriale, ndërsa me datën 11.03.2022 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga organi i punësimit së bashku me provat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave për marrjen e vendimit meritor administroj këto prova: Ankesën me numër A.nr.159/2022 me numër të protokollit 952/2022 të parashtruar nga ankuesi me datën 23.02.2022 përmes e-mailit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formulari i regjistrimit të ankesës ; Vlerësimi i rezultateve në punë për vitin 2021 i panëshkruar; Raporti vjetor i datës 31.12.2021; Raporti vjetor i vitit 2021 i Agjencisë për pronësi industriale; Përgjigje në ankesë nga organi i punësimit e datës 11.03.2022 me numër protokollit 1299/2022 bashkë me shkresat e lëndës; Akt emërimi i datës 21.06.2019; Përshkrimi i detyrave të punë i datës 22.03.2017; E-mail zyrtar i datës 04.03.2022; Formulari për vlerësimin e punës provuese i datës 19.06.2020; E-mail zyrtar i datës 07.03.2022; Vendimi i datës 20.08.2021 me nr.02/Nr.113 për caktimin e zëvendësues i Zyrtares së lartë për ekzaminimin ; Vendimi i datës 25.11.2021; Vlerësimi vjetor i punës së zyrtarit Raport vjetor i punës për periudhën janar -dhjetor 2021; Plani vjetor i punës të Departamentit të Agjencisë; E-mail zyrtar i datës 24.02.2022- propozim për fillimin e procedurave disiplinore ndaj zyrtarit mesazh i datës 29.12.2021 për Drejtorin e Përgjithshëm në Agjencinë për pronësi Industriale; E-mail i datës 08.02.2022; E-mail zyrtar i datës 09.02.2022; E-mail zyrtar i datës 14.01.2022; E-mail zyrtar i datës 24.11.2021; E-mail zyrtar i datës 23.11.2021; E-mail zyrtar i datës 22.11.2021; E-mail zyrtar i datës 24.11.2021; E-mail zyrtar i datës 21.11.2021; E-mail zyrtar i datës 19.11.2021; E-mail zyrtar i datës 30.11.2021; E-mail zyrtar i datës 15.12.2021-vërejtje me shkrim; dy foto;E-mail zyrtar i datës 14.01.2022; E-mail zyrtar i datës 04.03.2022; E-mail zyrtar i datës 02.03.2022; E-mail zyrtar i datës 09.02.2022; E-mail zyrtar i datës 08.02.2022; E-mail zyrtar i datës 09.02.2022; E-mail zyrtar i datës 19.01.2022; E-mail zyrtar i datës 14.12.2022; E-mail zyrtar i datës 20.12.2021; E-mail zyrtar i datës 14.12.2021; E-mail zyrtar i datës 24.11.2021-Refuzim për dhënie informacioni me shkresa; E-mail zyrtari datës 24.11.2022; E-mail zyrtar i datës 24.11.2021 -kërkesë për sqarim;E-mail zyrtar i datës 21.11.2021; E-mail zyrtar i datës 19.11.2021; E-mail zyrtar i datës 30.11.2022 -Gjuha fyese në kundërshtim me kodin e etikës; E-mail zyrtar i datës 22.11.2021-justifikime mos me kryer punën; E-mail zyrtar i datës 19.11.2021-kërkesë për shqyrtim; E-mail zyrtar i datës 17.11.2021; E-mail zyrtar i datës 21.11.2021-prova shtesë për rastin e murit vinkel; E-mail zyrtar i datës 21.11.2021; E-mail zyrtar i datës 19.11.2021 -kërkesë; E-mail zyrtar i datës 19.11.2021; E-mail zyrtar i datës

08.11.2021; E-mail zyrtar i datës 18.10.2021; E-mail zyrtar i datës 02.02.2021; E-mail zyrtar i datës 28.10.2021; E-mail zyrtar i datës 15.09.2021; E-mail zyrtar i datës 05.10.2021-kërkesë për takim; E-mail zyrtar i datës 28.09.2021; E-mail zyrtar i datës 28.09.2021; E-mail zyrtar i datës 28.09.2021;-kërkesë; E-mail zyrtar i datës 06.09.2021; E-mail zyrtar i datës 06.09.2021-kërkesë ,E-mail zyrtar i datës 14.09.2021. E-mail zyrtar i datës 01.04.2022; Vendimi i datës 13.07.2021 me nr.11/35 dhe Vendimi i datës 28.07.2021 me numër protokolli 5467.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të bashkëngjitura si nga ankuesi ashtu edhe nga organi i punësimit ka vërtetuar se ekziston baza ligjore për të vendosur, që lënda e ankuesit të kthehet në rivlerësim, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon se vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2021, iu është bërë pa as një konsultim ose bisedë paraprake nga ana e eprorit të tij të drejtpërdrejt, pa nënshkrim të vlerësuesit, si dhe vlerësimin e rezultateve të punës e konsideron se është bërë në mënyrë degraduese dhe ofenduese.

Vlerësimi për është bërë vetëm për pesë(5) muajt e fundit të vitit 2021, ndërsa për muajt paraprak të vitit 2021 ankuesi nuk është i vlerësuar e që ky vlerësim është në kundërshtim me nenin 5 paragrafit 2 të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publikë që ka përcaktuar se: *“Nëse gjatë periudhës së vlerësimit, ndërrohet mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i nëpunësit para përfundimit të vlerësimit vjetor, ai vlerëson nëpunësin vetëm për periudhën përkatëse, ndërsa për periudhën e mbetur të vlerësimi vjetor, vlerësimi bëhet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejt pasues”*, rrjedhimisht në kuptim të kësaj dispozite ligjore si dhe bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji ka konstatuar se sipas Vendimit me numër 11/35 të datës 13.07.2021, Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë për Pronësi Industriale/MINT si mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i ankuesit është liruar nga detyra si drejtor i kësaj drejtorie, mirëpo vlerësimi i rezultateve në punë për ankuesin deri në këtë periudhë do duhej të bëhej po nga i njëjti, ngase ka qenë obligim i tij ligjor, ndërsa për periudhën nga data 26.11.2021 do duhej të bëhej nga mbikëqyrësi pasues si mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i ankuesit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave, pas analizimit të formularit për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021 për ankuesin, ka konstatuar që ankuesi në ankesën e tij ka theksuar faktin që formularin e vlerësimit për periudhën Gusht-Dhjetor për vitin 2021, e ka pranuar me datën 03.02.2022, ndërsa nga provat e dërguara nga organi i punësimit/ Agjencia për Pronësi Industriale /MINT, në formularin e vlerësimit tek pjesa *“ komentet e të vlerësuarit në rast se është i pakënaqur me vlerësimin e objektivave dhe aftësive”*, del se ankuesi në këtë vlerësim nuk e ka vendosur nënshkrimin e tij e as datën se kur e ka pranuar të njëjtin, mirëpo i njëjti mban datën 01.03.2022. Ndërlidhur me këtë Kolegji konstaton se vlerësimi është bërë në kundërshtim me nenin 43 paragrafin 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, ku përcaktohet se: *“1. Vlerësimi i rezultateve në punë është proces i përhershëm, që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave të paracaktuar dhe vlerësimin e sjelljes profesionale të nëpunësit civil në realizimin e objektivave. Periudha e vlerësimit zgjat 1 vit dhe fillon nga 1 janari dhe mbaron më 31 dhjetor. Vlerësimi bëhet deri më 31 janar të vitit të ardhshëm, për vitin pasues. 2.*

Vlerësimi i rezultateve në punë bazohet në objektivat e përcaktuar në mënyrë individuale për nëpunësin që vlerësohet, në përputhje me përshkrimin përkatës të punës dhe objektivat e njësisë apo institucionit” si dhe me nenin 8 paragrafin 2 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, ku thuhet se: *“2. Periudha e vlerësimit zgjat 1 vit dhe fillon nga 1 janari dhe mbaron më 31 dhjetor. Vlerësimi bëhet deri më 31 janar të vitit të ardhshëm, për vitin paraprak”,* e që afati lidhur me vlerësimin e rezultateve në punë duhet të bëhet deri me datën 31.01.2022 nga ana e udhëheqësit të drejtpërdrejtë të ankuesit dhe i njëjti ti dorëzohet ankuesit, andaj vlerësimi në rastin konkret për ankuesin si i tillë nuk konsiderohet se ka përfunduar.

Lidhur për faktin se mbikqyrësi i drejtpërdrejtë i ankuesit tashmë nuk është në pozitë të Drejtorit të Përgjithshëm i Agjencisë për Pronësi Industriale/MINT, ndërsa sipas ligjit Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, vlerësimi i rezultateve në punë për ankuesin deri në këtë periudhë do duhej të bëhej po nga i njëjti konformë nenit 43 paragrafi 5, i cili paragrafë specifikishtë parasheh *“Nëpunësi civil vlerësohet nga mbikëqyrësi i tij i drejtpërdrejtë. Në rastin e ndërrimit të mbikëqyrësit përpara përfundimit të vlerësimit vjetor, ai vlerëson nëpunësin vetëm për periudhën përkatëse”,* ngase ka qenë obligim i tij ,andaj mbi këtë bazë është konstatuar se vlerësimi prej muajit Janar deri në Gusht për vitin 2021 ankuesit nuk ju ka bërë dhe se është obligim Ligjor i Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë për Pronësi Industriale/MINT si Zyrtarë kryesor Administrativë që të ndërmer veprimet me qëllim që të sigurohet që Drejtori i Përgjithshëm që ka qenë në cilësi të eprorit të ankuesit të bëjë vlerësimin për periudhën sa ka qenë eprorë i ankuesit, konformë dispozitave të potencuara më lartë .

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren 02/2018, për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.159/2022, datë 08.04.2022

Sabile AVDYLI

Sabile Avdyli

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- ❖ Ankuesit
- ❖ Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë për Pronësi Industriale / MINT;
- ❖ Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregëtisë dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së.

